

AMANETI

Shejhu: Ali Abdurrahman El-Hudhejfi

15/7/1424H

Falenderimi i takon Allahut, të Mençurit, të Gjithëdijshmit, Mbretit, të Shenjtit, të Pastërtit, Siguruesit, Mbikqyrësit, Krenarit, Mbizotëruesit, të Madhëruarit. I lartësuar është Allahu nga ajo që i mveshin. Ai i krijoi krijesat që ta adhurojnë. Ai nuk pyetet për çfarë vepron por gjithëcka tjetër veç Tij pyetet. Atë e lavdëroj dhe falenderoj për mirësitë që ka dhënë, Ai është ashtu siç e ka lavdëruar vetë veten e Tij. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Një e i pashoq dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij, atë e përzgjedhi Zoti i tij, i zbriti dritën e qartë dhe e udhëzoi në rrugën e drejtë. O Allah! Fale dhe përshëndete robin dhe të dërguarin Tënd, Muhammedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) "**Ne u ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk pranuan ta marrin përsipër atë e u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete. Me të vërtetë ai ishte i padrejtë** (ndaj vetes së tij) **dhe i padijshëm.** (Njeriu e mori për sipër) **Kështu që All-llahu të ndëshkojë hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët dhe idhujtarët, e t'i fali besimtarët dhe besimtarët. Dhe All-llahu ishte falës e mëshirues.**" (El-Ahzab: 72-73) Një peshë e rëndë, detyrë e madhe dhe çështje e rrezikshme iu ofrua qiejve, tokës dhe maleve por ato u drodhën dhe nuk pranuan që ta mbanin atë duke u frikësuar nga ndëshkimi i Allahut. Pastaj ai amanet iu paraqit Ademit alejhis-selam i cili e morri përsipër mbajtjen e tij. "**Me të vërtetë ai ishte i padrejtë** (ndaj vetes së tij) **dhe i padijshëm.**" Pra njeriu i cili nuk e mban amanetin është i padrejtë dhe i padijshëm e jo Ademi alejhis-selam. Ibn Abbasi (Allahu qoftë i kënaqur prej të dyve!) ka thënë: *Amaneti janë detyrat të cilat Allahu ia paraqiti qiejve, tokës dhe maleve që nëse do t'i kryenin Ai do t'i shpërblente e në rast të kundërt do t'i ndëshkonte. Ata nuk e pëlqyen një gjë të tillë dhe u frikësuan, pa kundërshtuar kështu Zotin e tyre por duke e madhëruar fenë e Allahut.*

Hasen El-Basri (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: *Ato (detyrat) iu paraqitën shtatë qiejve të zbukuruar me yje dhe engjëjve që mbajnë Arshin dhe iu tha: A do ta mbani amanetin dhe gjithë çka lidhje me të? Thanë: Çfarë ka në të? Iu tha: Nëse e plotësoni do të shpërbleheni e nëse nuk e plotësoni do të ndëshkoheni. Thanë: Jo. Pastaj iu paraqitën shtatë tokave. Iu tha: A do ta mbani amanetin dhe gjithë çka lidhje me të? Thanë: Çfarë ka në të? Iu tha: Nëse e plotësoni do të shpërbleheni e nëse nuk e plotësoni do të ndëshkoheni. Thanë: Jo. Pastaj iu paraqitën maleve të cilët përsëri nuk pranuan.*

Amaneti përfshin gjithë detyrat e Sheriatit, të drejtat e Allahut dhe të njerëzve, kush i plotëson ato shpërblehet e kush i lë pas dore ndëshkohet. Imam Ahmedi, Bejhakui dhe Ibn Ebi Hatim transmetojnë nga Abdullah ibn Me'udi (Allahu qoftë i

kënaqur prej tij!) se ka thënë: *Namazi është amanet, abdesi është amanet, peshimi është amanet, matja është amanet.* Dhe përmendi disa gjëra të tjera. Dhe më e madhja prej tyre janë porositë. Ebu Darda (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ndër të tjera ka thënë: *Larja pas xhunubllëkut është amanet.* Prandaj kush ka si cilësi të tij besnikërinë e mbajtjen e amanetit ai e ka plotësuar fenë e tij e kush e humbet këtë cilësi ai e ka hedhur tej fenë. Transmeton Tabaraniu prej Ibn Umerit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: **"Nuk ka bësım ai i cili nuk ka amanet."** Ndërsa Ahmedi, Bezzari dhe Tabaraniu transmetojnë prej Enesit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: **"Nuk ka besım ai i cili nuk ka amanet dhe nuk ka fe ai i cili nuk ka besë."** Prandaj besnikëria dhe mbajtja e amanetit ishte cilësi e pejgamberëve dhe njerëzve të mirë. Allahu i Madhëruar ka thënë për Nuhun, Hudin dhe Salihun alejhmus-selam se secili prej tyre i tha popullit të tij: (ky është komentimi i ajetit) **"Unë jam për ju i dërguar, besnik. Prandaj frikësojuni (dënimin të) All-llahut dhe bindmuni mua."** (Esh-Shuara: 107-108) Sa më shumë të pakësohet besnikëria aq më shumë pakësohen pjesët e besimit siç ka transmetuar Muslimi nga Hudhejfe (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Muhammedi alejhis-selam ka thënë: **"Amaneti zbriti në rrënjët e zemrave të burrave (pra në mes të tyre) pastaj zbriti Kur`anit dhe mësuan prej Kur`anit dhe prej Sunnetit."** Pastaj foli për humbjen e amanetit i cili do të hiqet pak nga pak nga zemrat e njerëzve e së fundi morri një guriqkë e hodhi mbi këmbë e tha: **"Pastaj njerëzit vazhdojnë të lidhin besa por pothuajse asnjëri nuk e mban amanetin. Derisa të thuhet: Tek filan fis është një burrë besnik. E derisa të thuhet për ndonjë person: Sa i mirë, sa i llogjikshëm është. Por në zemrën e tij nuk do të ketë besim as sa një grimcë."** Kuptohet nga hadithi se personi nëse me qëllim do ta humbasi besnikërinë dhe amanetin duke lënë pas dore detyrat e fesë e duke mashtruar në të drejtat e robërve ka për tu ndëshkuar me heqjen e besnikërisë prej zemrës së tij. Allahu nuk mund ta heqi besnikërinë nga zemra e dikujt pa shkak ashtu siç ka thënë vetë Allahu i Madhëruar: (ky është komentimi i ajetit) **"E kur ata u shmangën (nga e vërteta), All-llahu i shmangu zemrat e tyre, e All-llahu nuk e udhëzon popullin e prishur."** (Es-Saff: 5) Fundi i hadithit tregon se amaneti është vetë besimi, ai është vetë feja dhe detyrat e saj, Teuhidi është amanet, namazi është amanet, zekati është amanet, agjërimi është amanet, haxhi është amanet, ruajtja e lidhjeve farefisnore është amanet, urdhërimi për të mirë është amanet, ndalimi nga e keqja është amanet, pasuria është amanet prandaj mos e përdor atë për harame, syri është amanet prandaj mos shiko me të aty ku ka ndaluar Allahu, dora është amanet, organi seksual është amanet, barku është amanet prandaj mos ha atë që nuk të lejohet, fëmijët janë amanet tek ty prandaj mos e lë pas dore edukimin e mirë të tyre, gratë janë amanet tek burrat prandaj mos i shpërdoro të drejtat e tyre, të drejtat e burrave ndaj grave janë amanet, të drejtat e robërve janë amanet prandaj mos i shpërdoroni ato. Allahu i Madhëruar ka premtuar shpërblim të madh për ata që mbajnë amanetin dhe i japin atij të drejtën e duhur. Allahu i Madhëruar ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) **"Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë amanetet dhe premtimin e dhënë. Dhe ata të cilët janë të kujdesshëm për namazet e tyre. Të tillët janë ata trashëgimtarët. Të cilët e trashëgojnë Firdeusin, aty janë të përjetshëm."** (El-Mu'minun: 8-11) Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) transmetohet se Pejgamberi alejhis-selam ka thënë: **"Më garantoni** (se do t'i

ruani) **gjashtë gjëra t'ju garantoj Xhennetin.**" Ebu Hurejre tha: Cilat janë ato (gjashtë gjëra) o i Dërguari i Allahut? Tha: **"Namazi, zekati, amaneti, organi seksual, barku dhe gjuha."** El-Mundhiri ka thënë për senedin e hadithit se nuk ka ndonjë problem.

Mosmbajtja e amaneteve dhe lënia pas dore e detyrave të fesë shkakton mangësi dhe shkatërrim të përfitimeve të njerëzve, e bën jetën të hidhur, përfitimet personale dhe shoqërore i çon drejt rrezikut dhe shkatërrimit, prish mbarrëvajtjen dhe e çon gjithësinë drejt shkatërrimit. Kur Muhammedi sal-lallahu alejhi ue sel-lem u pyet se kur do të ndodhë Kijameti tha: **"Kur të humbasi amaneti prite Kijametin."** Prandaj frikësojuni Allahut o njerëz dhe mbajini siç duhet amanetet, kryejini detyrat dhe largojuni haramëve. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"Dhe ata të cilët me kujdes i ruajnë amanetet dhe premtimin e dhënë. Edhe ata që dëshminë e vet e zbatojnë (nuk e mohojnë, nuk e fshehin). Edhe ata që janë të kujdesshëm ndaj namazit të tyre. Të tillët janë të nderuar nëpër Xhennete."** (El-Mearixh: 32-35)

Frikësojuni Allahu me sinjeritet të plotë dhe bindjuni duke zbatuar urdhërat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij që kështu të fitoni Xhennetin dhe kënaqësinë e Tij. Allahu i Madhëruar ka thënë: (Ky është komentimi i ajetit) **"All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni mes njerëzve, të gjykoni me drejtësi. Sa e mirë është kjo me të cilën Allahu po ju këshillon. Me të vërtetë Allahu ishte dëgjues, shikues (i asaj që veproni)."** (En-Nisa: 58) Ky ajet ka përfshirë të gjitha llojet e amaneteve e prej më të rëndësishmeve prej tyre janë postet dhe detyrat zyrtare, kush plotëson në to detyrat që ka ndaj Allahut dhe i shërben muslimanëve duke u plotësuar atyre kërkesat dhe problemet që kanë ai person me të vërtetë që e ka këshilluar veten e tij dhe ka bërë të mira për Ahiretin e tij. Ndërsa kush nuk i kryen siç duhet detyrat që i janë caktuar aty dhe nuk plotëson kërkesat e njerëzve, merr rryshfet ose merr pa të drejtë pasurinë e muslimanëve ai person ka mashtruar veten e tij dhe i ka bërë asaj padrejtësi. Në sahihun e Muslimit transmetohet se Pejgamberi sal-lallahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **"Kur Allahu i Madhëruar dëton e Kijametit të grumbullojë të parët dhe të fundit, për çdo mashtrues do të ngrihet një flamur e do të thuhet: Ky është mashtrimi i filanit të birit të filanit."**

Prej amaneteve më të rëndësishme janë porositë dhe detyrat për të cilat njerëzit të kanë lënë kujdestar. Imam Ahmedi dhe Bejhakiu transmetojnë se Ibn Mes'udi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ka thënë: **Vrasja (të vritesh) në rrugë të Allahut i fshin të gjitha gjynahet përveç amanetit** (që nuk është mbajtur). **Sillet personi dëton e Kijametit dhe i thuhet: Çoje në vend amanetin. Thotë: Si o Zot ndërkohë që dynjaja ka mbaruar. Thuhet: Çojeni në Hauije** (zjarr i nxehtë në Xhehennem). **E çojnë në Hauije dhe amaneti i pambajtur i shfaqet në pamjen që kishte kur iu dha në kujdes e ai e shikon dhe e njeh. Lëshohet pas tij derisa e kap dhe e merr mbi supe e kur mendon se doli (prej zjarrit) i bie nga supet e ai lëshohet pas tij përjetësisht."**

O robërit e Allahut! Allahu i Madhëruar ju ka urdhëruar që të bëni salavate dhe të përshëndesni pejgamberin e Tij të zgjedhur. Ai ka thënë: (ky është komentimi i ajetit) **"Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e lavdërojnë Pejgamberin. O ju**

që keni besuar, lavdërojeni atë (duke bërë salavate për të) dhe përshëndeteni me selam." (El-Ahzab: 56)

www.alharamainonline.org